



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E METROLOGJISË  
DREJTORIA E METROLOGJISË SHKENCORE DHE INDUSTRIALE

Nr. 126 prot.

Tiranë, më 20.06.2024

Lënda: Mbi kërkesën për informacion

Në përgjigje të kërkesës Suaj, dërguar me e-mail më datë 27.06.2024 "Informacion", protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë (DPM) me nr.1269 prot, datë 27.06.2024, Ju bëjmë me dije si më poshtë.

Në mbështetje dhe zbatim të ligjit nr.126, datë 15.10.2020 "Për Metrologjinë", Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë kryen detyrat dhe kompetencat e saj, të cilat ndër të tjera janë: kryen verifikim periodik të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara, përveç rasteve kur me një nga format e parashikuara në legjislacionin në fuqi është autorizuar ofrimi i këtyre shërbimeve nga ana e personave juridikë private, si dhe kalibrimin e instrumenteve matëse.

Në mbështetje dhe zbatim të nenit 17, të ligjit nr.126, datë 15.10.2020 "Për Metrologjinë", instrumentet matëse ligjërisht të kontrolluara janë instrumentet matëse që përdoren në transaksionet tregtare dhe zyrtare për arsye të interesit publik, për sigurinë dhe rendin, mbrojtjen e konsumatorit dhe mjedisit, për mbledhjen e taksave dhe detyrimeve dhe tregtisë së ndershme; kontrollin e produkteve të parapaketuara dhe shisheve sj enë matëse; matjet e përshkruara nga ky ligj dhe rregulla të përshtatura për zbatimin e tyre, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë ndikojnë në jetën e përditshme të qytetarëve.

Pra, për kategorinë e instrumenteve matëse të cilët përdoren në fushat dhe qëllimet e sipërcituara, shërbimi i verifikimit të tyre është i detyrueshëm ligjërisht.

Ndërsa, referuar nenit 16, të ligjit nr.126, datë 15.10.2020 "Për Metrologjinë", shërbimi i kalibrimit të instrumenteve matëse kryhet me kërkesën e përdoruesit. Pra, sipas ligjit "Për Metrologjinë", shërbimi i kalibrimit nuk përbën detyrim ligjor, por është fakultativ/vullnetar/me dëshirë.

Gjithashtu, Ju informojmë se, institucione të caktuara referuar ligjeve të tyre specifike, kalibrimin e instrumenteve matës e kanë të detyruar. Si dhe nëse subjekti përdorues i instrumenteve matës operon në përputhje me standarde respektiv ndërkombëtar (ISO), për shërbimin që ofron, ai duhet të kalibrojë instrumentet matës si kërkesë e standardit, për sigurimin e cilësisë.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Petrit Rama**

